



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35/2020 regjistër (JR)
Datë 11.09.2020

Nr. 28 i vendimit
Datë 14.07.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 14.07.2022, ditën e enjte, në orën 13:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 35/2020, datë 11.09.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2 e neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe konkluzione përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi dhe dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të

subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj dhe avokates të tij B. D., të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ludovik Dodaj, në kohën e ushtrimit të detyrës së prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës¹, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin³ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse,

¹ Subjekti i rivlerësimit, në kohën e shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka ushtruar detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

² “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ludovik Dodaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës” është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.05.2018.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KZHD-së nr. {***}, datë 11.09.2019, është përcjellë në Komision nga DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2019.

⁴ “Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Ludovik Dodaj” i KLP-së, me nr. {***} prot., datë 26.12.2019.

siç janë pasqyruar në paragrafët më sipër në këtë vendim, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale – duke marrë vendimin nr. 255, datë 08.06.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 255, datë 08.06.2020, vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

6.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

[...] subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Subjekti rezulton me një bilanc negativ në vitin 2008 në shumën 358.816 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në vitin 2008 nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...] subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

6.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë Deklaratën e Kontrollit të Figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se, subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

6.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjyqës vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të

drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. [...] subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ludovik Dodaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme.
 - a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
 - b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
 - c. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë.

III. Shkaqet e ankimit

8. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Ludovik Dodaj. Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
9. Komisioneri Publik ka evidentuar shkaqe lidhur me nevojën për kontrollin e vendimit të Komisionit nga Kolegji, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, që lidhen me:
 - (i) *pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarinë e subjektit për pasurinë e paluajtshme, të llojit apartament banimi;*
 - (ii) *pamjaftueshmërinë financiare për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet për vitet 2013-2014;*
 - (iii) *çështje të tjera lidhur me vlerësimin e etikës profesionale të subjektit.*
10. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 e 61 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:
 - o *Ndryshimin e vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të

Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁵, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 255, datë 08.06.2020, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
Komisioneri Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale, duke pretenduar, në konkluzionet përfundimtare, se aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk mbështesin konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë.
14. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancën gjyqësore publike të datës 07.06.2022, subjekti i rivlerësimit prapësoi pretendimet e Komisionerit Publik, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor për marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore, të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, si dhe kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit.
Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm⁶, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.
15. Trupi gjykues, për nevoja të hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale mbi ankimin e Komisionerit Publik, vendosi të kërkojë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, dosjen gjyqësore të vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të kësaj gjykate. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2020, përcolli në Kolegj kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit të sipërcituar, e cila iu vu paraprakisht në dispozicion subjektit të rivlerësimit e Komisionerit Publik, dhe u administrua në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 27.06.2022.

⁵ Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.02.2020, ka njoftuar Institucionin e Komisionerëve Publikë për vendimin nr. {***}, datë 28.01.2020, e cila është regjistruar në Institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 27.02.2020. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.07.2020, ka përcjellë pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 255, datë 08.06.2020, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj, ankim i regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 09.07.2020.

⁶ Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 07.06.2022.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, në lidhje me pretendimet sipas shkaqeve të ankimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë

16. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit ka pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarin e subjektit të rivlerësimit për pasurinë e paluajtshme të llojit apartament banimi me sipërfaqe 108,48 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, {***}, Durrës, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
17. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë bindëse dhe se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

26.9 [...] Subjekti ka deklaruar se ka përfitur një shumë prej 300.000 lekë nga shitja e mobilieve të këtij apartamenti, por pa dorëzuar dokumentacion provues. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar shkresa të thjeshta për të provuar shitjen e mobilieve. Komisioni vlerëson se pavarësisht njohjes apo jo të shumës 300.000 lekë (si e ardhur nga shitja e mobilieve), subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash në shumën 2.200.000 lekë të deklaruar në DVP/2003. [...]

26.13 Subjekti, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, ka depozituar dokumentet “shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat personave fizik në bazë të deklarinimit fillestar” të z. A. D., për periudhën 2005-2014. Bazuar në këtë dokumentacion rezulton se kunati i subjektit, për periudhën 2005-2009, ka krijuar të ardhura në shumën 54.413 euro, të cilat janë të mjaftueshme për dhënien e huas 8.000 euro.

26.15 Nga analiza financiare e kryer për vitet 2006-2012, subjekti rezulton me mungesë mjeteshe financiare në shumën 358.816 lekë për vitin 2008 [...] Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, çmon se nisur nga vlera e këtyre shpenzimeve, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre shpenzimeve të pambuluara, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se balanca negative në vitin 2008, nuk mund të shërbejë si shkak i vetëm për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
18. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me pretendimin se ai nuk mbështetet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe nuk është në harmoni me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë e paluajtshme të llojit apartament banimi, me sipërfaqe 108,48 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, {***}, Durrës (në vijim “apartamenti në Durrës”), pasi nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kryera në vitet 2006, 2008 dhe 2009. Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështet në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

18.1 Lidhur me pagesën e shumës 25.000 euro, gjatë vitit 2006, për shlyerjen e vlerës së apartamentit në Durrës, si burime të ligjshme duhet të konsiderohen:

 - a. vetëm shuma 1.900.000 lekë, e përfitur sipas kontratës së shitblerjes së apartamentit të banimit në Shkodër, pasi shuma e të ardhurave të realizuara nga shitja e pajisjeve shtëpiake prej 300.000 lekësh, nuk duhet të merret në konsideratë në situatën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, sepse burimi i kësaj shume nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003;

- b. tërheqjet në *cash* nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur nga data 01.01.2006 - 21.08.2006, që në total rezultojnë të jenë në shumën 1.022.152 lekë, si rezultat i tërheqjeve në *cash* të pagës nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij deri në datën 21.08.2006, si dhe interesave të përfituar nga depozita në USD, në vlerën 11.152 lekë⁷.

Sipas Komisionerit Publik, bazuar në konsiderimet e mësipërme, pagesat e kryera deri më 21.08.2006 për këstin e parë të pasurisë objekt kontrolli, nuk mbulojnë për një diferencë negative prej 463.959 lekësh, por edhe nëse konsiderohen pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me 300.000 lekë, përfituar nga shitja e mobilieve, përsëri rezulton pamjaftueshmëri për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kryera, për një diferencë negative prej 163.959 lekësh⁸.

18.2 Lidhur me pagesën e shumës 4.000 euro për shlyerjen e apartamentit në Durrës, në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesën e kryer, ashtu siç ka konstatuar edhe Komisioni, për një diferencë negative prej 358.816 lekësh. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit të parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, se kursimet e deklaruara në vitin 2008, në shumën 550.000 lekë, përfaqësojnë kursimet në llogari bankare dhe ato në *cash*, Komisioneri Publik vëren se ky është një pretendim i ndryshëm nga ai i parashtruar në shpjegimet e dhëna në Komision pas kalimit të barrës së provës, në të cilat ka pretenduar se ka pasur kursime nga vitet e mëparshme⁹.

18.3 Lidhur me pagesën e shumës 4.000 euro, më datë 16.09.2009, për shlyerjen e vlerës së apartamentit në Durrës dhe shlyerjen e parakohshme të kredisë në shumën 840.732 lekë, me burim krijimi huan e marrë nga z. A. D., në shumën 8.000 euro, Komisioneri Publik ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit nuk përputhet me situatën faktike, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e rivlerësimit, pasi nuk rezulton që Komisioni të ketë konsideruar në analizë edhe shpenzimet e jetesës së familjes së personit tjetër të lidhur, të përbërë prej katër anëtarësh, për periudhën 2005-2008, bazuar në të dhënat e *eurostat*-it. Sipas Komisionerit Publik, rezultojnë që shlyerja e parakohshme e kredisë është kryer në datën 03.02.2009, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit, shumën e marrë hua, e ka pasur në dispozicion më së paku në këtë datë. Për pasojë, të ardhurat e realizuara nga huadhënësi dhe bashkëshortja e tij deri më datë 31.01.2009, nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar njëkohësisht shpenzimet e jetesës në shtetin grek, si edhe huan e deklaruar, dhënë subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik pretendoi se edhe me provat e reja të administruara gjatë gjykimit në Kolegj¹⁰, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësitë financiare të z. A. D. për t'i dhënë huan e deklaruar, duke rezultuar kështu me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në datën 03.02.2009, si dhe shlyerjen e këstit të apartamentit, në datën 16.09.2009, për një diferencë negative më së paku prej -1.007.760 lekësh.

18.4 Në përfundim, për pasurinë objekt kontrolli, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të mbuluar pagesat dhe shpenzimet e kryera për një diferencë negative, në total, në shumën 1.530.535 lekë¹¹.

⁷ Shih parashtrimet e Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 07.06.2022, paragrafi 1.7.6.

⁸ Shih konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 27.06.2022, paragrafi 1.1.

⁹ *Ibid.*, paragrafi 1.2.1.

¹⁰ *Ibid.*, paragrafi 1.3.

¹¹ *Ibid.*, paragrafi 1.4.

19. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me pasurinë apartament në Durrës, janë të pabazuara. Ai prapësoi se ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

19.1 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ka deklaruar para në *cash*, në shumën 2.200.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në qytetin e Shkodrës, duke iu referuar vetëm burimit të shitjes së apartamentit dhe jo kursimeve të tjera, pasi vlera e shitjes së banesës në Shkodër përbënte pjesën më të madhe të të ardhurave. Shitja e pajisjeve shtëpiake, në shumën 300.000 lekë, lidhej gjithashtu me momentin e shitjes së apartamentit dhe është përvetësuar njëkohësisht, prandaj edhe është deklaruar në tërësi shuma *cash* e të ardhurave të përfituara. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar saktësisht se burimi për pagesën e këstit të parë për apartamentin, në shumën 25.000 euro, ishte nga shitja e apartamentit në Shkodër, në shumën 1.900.000 lekë dhe nga shitja e pajisjeve të tij në shumën 300.000 lekë, duke korrigjuar e saktësuar edhe deklarin e vitit 2003 për gjendjen e likuiditeteve në *cash* në fund të vitit 2003, në shumën totale prej 2.200.000 lekësh. Shuma prej 300.000 lekësh, e përfituar nga shitja e pajisjeve shtëpiake, përmbush kriteret e së ardhurës së ligjshme, pasi është deklaruar në kohën kur e ka përfituar dhe është në përputhje të plotë me mundësinë e tij paguese/blerëse të vlerës së këtyre sendeve dhe, për rrjedhojë, vlera nga shitja e tyre është poseduar në *cash* në kohën kur e ka deklaruar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në kushtet e deklarin të parë, ka deklaruar burimin e krijimit për gjendjen e likuiditeteve në *cash*, pa asnjë qëllim për të shmangur, modifikuar apo për t'i paraprirë ndonjë situatë të mëvonshme.

19.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi gjithashtu edhe konstatimin e Komisionerit Publik se duhet të konsiderohen si burime të ligjshme për shlyerjen e pagesave të apartamentit gjatë vitit 2006, vetëm tërheqjet në *cash* nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur nga data 01.01.2006 - 21.8.2006, që në total rezultojnë të jenë në shumën 1.022.152 lekë, me pretendimin se shumës në *cash* prej 2.200.000 lekësh, duhet t'i shtohen edhe kursimet e viteve 2004 dhe 2005, të cilat janë deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të apartamentit. Kursimet *cash* në vitet 2004 dhe 2005, janë deklaruar në procesverbalin e mbajtur nga inspektorët e ILDKPKI-së më datë 08.04.2016, në të cilin ka deklaruar saktësisht se kursimet në *cash* të krijuara gjatë vitit 2004, kanë qenë rreth 400.000 lekë dhe gjatë vitit 2005, kanë qenë rreth 500.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza e burimit për pagesën e këstit të parë të apartamentit, duhet të shtrihet mbi tërheqjet nga llogaritë bankare, por duke mbajtur parasysh edhe kursimet në *cash* që i ka pasur të krijuara ndër vite, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të interesave në vitet 2004 dhe 2005, por janë deklaruar si burim krijimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Për këto arsye, analiza financiare deri në momentin e pagesës së shumës së fundit për këstin e parë, rezulton me balancë pozitive, që do të thotë se subjekti kishte mundësi për të përballuar të gjithë vlerën e këstit të parë të çmimit të apartamentit.

19.3 Lidhur me pagesën e shumës 4.000 euro për shlyerjen e apartamentit në Durrës, në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik se nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesën e kryer, duke argumentuar se në deklaratën e interesave të vitit 2008, ka deklaruar se ka kursyer 550.000 lekë, si shumë totale e parave të kursyera në *cash* në shumën 350.000 lekë dhe 200.000 lekë në llogari bankare, pasi në atë kohë ka pasur perceptim të gabuar për mënyrën se si deklarohen kursimet. Për pasojë, diferenca negative

e konstatuar nga Komisioneri Publik, mbetet në shumën 158.816 lekë, diferencë kjo e justifikueshme, duke mbajtur në konsideratë se, sipas analizës financiare të kryer në Komision, në fund të vitit 2007, subjekti kishte mundësi të kursente shumën prej 698.931 lekësh.

19.4 Për sa i përket shumës 8.000 euro, të marrë hua nga z. A. D., subjekti i rivlerësimit pretendoi se në arritjen e konkluzionit se huadhënësi nuk kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumën e dhënë hua, Komisioneri Publik, pa të drejtë, nuk ka njohur të ardhurat e krijuara nga z. A. D. në vitin 2009. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik, nga kjo shumë mund të zbriste vetëm kursimet e mundshme për vitin 2009, por jo të shuante ligjshmërinë dhe mundësinë kursyese të z. A. D. në vitet e tjera. Për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare, subjekti i rivlerësimit nuk ka lidhur kontratë huaje me z. A. D., por i ka kërkuar atij ta ndihmonte në shlyerjen e kredisë, e cila, për shkak të interesave, e kishte vënë në vështirësi për të kursyer. Me huan e marrë nga huadhënësi në janar të vitit 2009, në shumën 6.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka shlyer kredinë në muajin shkurt, për aq sa ishte vlera, 840.000 lekë. Në muajin shtator, subjekti i rivlerësimit i ka marrë huadhënësit shumën prej 2.000 eurosh, të cilën ua bashkoi kursimeve të veta, të krijuara nga muaji shkurt deri në muajin gusht, për të paguar këstin e radhës prej 4.000 eurosh. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyetimi i Komisionerit Publik në lidhje me fshirjen e plotë të të ardhurave të z. A. D., për vitin 2009, bie poshtë, pasi për efekt të ligjit nr. 9049/2003, deklarimi i huas do të duhej të bëhej në vlerë të plotë, brenda vitit financiar të deklarimit. Nga dokumentacioni i paraqitur në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, rezulton se për periudhën kohore 2003-2008, të ardhurat e përfituara nga z. A. D. janë të mjaftueshme për të kursyer shumën e dhënë hua. Ligjshmëria e të ardhurave të huadhënësit nuk mund të vihet në diskutim, pasi ai, me marrjen e lejes së qëndrimit, ka punuar gjithmonë i siguarur dhe të ardhurat e tij janë tatuar nga sistemi ligjor grek. Z. A. D. ka punuar së bashku me bashkëshorten, në punë në bujqësi dhe shpenzime jetike në këtë kohë nuk ka pasur aspak, pasi gjatë kohës që kanë punuar në bujqësi, kanë banuar në shtëpinë e familjes që i kishte punësuar, me ushqim dhe fjetje të siguarur. Nisur edhe nga distanca e largët në kohë, për periudhën për të cilën është dhënë shpjegim (2003 – 2008), subjekti i rivlerësimit pretendon se, pavarësisht gjithë dëshirës dhe vullnetit për të qenë bashkëpunues, e ka të pamundur të paraqesë një përlllogaritje të shpenzimeve për jetesë dhe, për pasojë, edhe të të ardhurave *neto* të kursyera nga z. A. D. dhe bashkëshortja e tij.

- 20.** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë apartament në Durrës, pasi analizoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni, si dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit e të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka poseduar pasurinë apartament me sipërfaqe 108,48 m² në Durrës, për shkak të lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006, me shoqërinë ndërtimore “{***}” ShPK, me objekt financimin nga porositësi Ludovik Dodaj të një apartamenti me sipërfaqe të brendshme 108,48 m², me çmim 45.140 euro, prej të cilave 15.000 euro janë paguar nga porositësi dhe janë marrë në dorëzim nga sipërmarrësi, ndërsa pjesa tjetër e çmimit do të paguhej nga porositësi, me këste, në llogarinë e sipërmarrësit, deri në dhjetor të vitit 2007. Kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 05.10.2013, është lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e palës shitëse, dhe znj. M. D. – bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – në cilësinë e palës blerëse. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pala shitëse deklaroi se pasurinë apartament, me sipërfaqe 108,48 m², ia shet palës blerëse për çmimin 45.000 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

Pasuria objekt kontrolli është regjistruar në ZVRPP-Durrës në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, me nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 04.11.2013.

20.2 Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur mandatarkëtimet për shumat e paguara prej tij shoqërisë “{***}” ShPK, si vijon:

- (i) mandatarkëtim nr. {***}, datë 07.01.2006, me përshkrim “Likuidim kësti për apartament”, me vlerë 5.000 euro;
- (ii) mandatarkëtim nr. {***}, datë 26.05.2006, me përshkrim “Këste për apartament te {***}”, me vlerë 10.000 euro;
- (iii) mandatarkëtim nr. {***}, datë 21.08.2006, me përshkrim “Pagesë kësti III, objekti {***}”, me vlerë 10.000 euro;
- (iv) mandatarkëtim nr. {***}, datë 11.09.2007, me përshkrim “Këste për apartament te {***}”, me vlerë 7.000 euro;
- (v) mandatarkëtim nr. {***}, datë 11.07.2008, me përshkrim “Këste për apartamentin {***}”, me vlerë 4.000 euro;
- (vi) mandatarkëtim pa numër, datë 16.09.2009, me përshkrim “Këst apartamenti {***}”, me vlerë 4.000 euro;
- (vii) mandatarkëtim pa numër, datë 23.10.2012, me përshkrim “Këst apartamenti objekti {***}”, me vlerë 5.000 euro.

21. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, si dhe të atyre të shtjelluara në vijim, trupi gjykues vlerësoi si më poshtë.

22. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se *shuma e të ardhurave të realizuara nga shitja e pajisjeve shtëpiake prej 300.000 lekësh, nuk duhet të merret në konsideratë në situatën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, sepse burimi i kësaj shume nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003*, trupi gjykues vëren se:

22.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si burime të krijimit të këstit të parë për blerjen e apartamentit në Durrës, ka deklaruar: *Sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006, paguar 25.000 euro në dorë, pjesa tjetër me këste. Shumë e cila është marrë nga kontrata e shitblerjes së shtëpisë në Shkodër, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006. Vlera e shtëpisë në Shkodër është 1.900.000 lekë. Përveç kësaj shume, nga shtëpia e Shkodrës, është përfituar dhe shuma 300.000 lekë, nga shitja e pajisjeve të shtëpisë. Gjithashtu, kësaj shume i janë shtuar dhe kursimet ndër vite, deri në 2006.*

22.2 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Para cash në banesë, vlera 2,2 milionë lekë. Burimi: Shitje shtëpie në Shkodër, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., viti 2002, muaji qershor, data 5.*

22.3 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2003¹², me palë shitëse Ludovik, M., M. dhe M. Dodaj dhe palë blerëse O. dhe E. L., apartamenti me sipërfaqe 73 m², i ndodhur në Shkodër, është shitur për shumën 1.900.000 lekë, shumë e cila është likuiduar mes palëve, jashtë zyrës noteriale.

¹² Kontrata e sipërcituar është përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 16.01.2019.

22.4 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të përcjella në Komision më datë 08.03.2020, në përgjigje të barrës së provës, për të depozituar dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e siguruar nga shitja e pajisjeve të apartamentit në Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Për t'i dhënë përgjigje kësaj pike, kam vlerësuar si mënyrë të vlefshme marrjen e deklaratave nga subjektet që i kanë blerë. Duke qenë se bëhet fjalë për sende të luajtshme, nuk kisha asnjë detyrim të bëja kontratë para noterit, si dhe vlera e ulët e secilit send, e përforcoi qëndrimin tim. Prandaj, pas kërkesës suaj, për shpjegim më të hollësishëm, u kam marrë deklaratat me shkrim z. A. T. (baxhanaku), znj. R. S. (fqinjë në pallatin ku kam banuar) dhe znj. R. Z. (me banim në Shkodër). Në lidhje me këtë fakt, kërkoj të merren në cilësinë e provës me dokument të procesit hetimor administrativ, deklaratat e njëanshme të shtetasve që përmenda më lart për shitjen e pajisjeve [...].*

22.5 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën e datës 04.03.2020 të znj. R. Z., deklaratën e datës 04.03.2020 të z. A. T. dhe deklaratën e datës 04.03.2020 të znj. R. S., të cilët deklarojnë se kanë blerë mobilie dhe pajisje elektroshtëpake nga znj. M. D., në vlerën totale prej 300.000 lekësh.

- 23.** Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, në raport me arsyetimin e Komisionit e prapësimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, gjendjen *cash* të parave në banesë, në shumën 2.200.000 lekë, e ka deklaruar si shumë që buronte nga shitja e apartamentit në Shkodër, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2003. Burimin e diferencës në shumën 300.000 lekë, mes çmimit të shitjes së apartamentit në Shkodër në vlerën 1.900.000 lekë dhe vlerës *cash* në banesë prej 2.200.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë në vitin 2003, subjekti e ka shpjeguar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si shumë që buron nga shitja e pajisjeve shtëpiake të këtij apartamenti. Këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar edhe në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, duke u përpjekur ta provojë me deklaratat të thjeshta të personave të pretenduar si blerës të mobilieve e pajisjeve shtëpiake, deklaratat të cilat Komisioni nuk i ka vlerësuar me efekt provues. Në arsyetimin e tij, Komisioni ka pranuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë shumën prej 300.000 lekësh si kursime *cash* deri në fund të vitit 2003, me burim nga të ardhurat e veta, por në vlerësimin e trupit gjykues, ky arsyetim është i pambështetur, pasi konsideron të mirëqenë një burim krijimi jo në përputhje me deklaratën e subjektit në vitin 2003 e tërësisht të ndryshëm nga ai i deklaruar prej tij në deklaratën e rivlerësimit dhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.
- 24.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën vlerë kursimesh në *cash*, prej 2.200.000 lekësh, si në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në atë të vitit 2003, dhe detajimin e shumave përbërëse të saj, prej 1.900.000 lekësh dhe 300.000 lekësh, e ka bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues i vlerësoi këto deklarime në përputhje me nenin 49, pika 1, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr. 84/2016¹³,

¹³ Neni 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në shkronjat “a” e “b” parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të këtij ligji; b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku [...]”.

dhe në mbështetje edhe të parashikimit të nenit 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil¹⁴, sipas të cilit, në kuadrin e marrëdhënies send kryesor - send aksesor, pajisjet shtëpiake mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë duke krijuar të ardhura më vete, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2003, ka disponuar shumën prej 300.000 lekësh në *cash*, të përfituar nga shitja e pajisjeve shtëpiake të apartamentit në Shkodër. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë dhe rrethanën specifike të provuar gjatë hetimit administrativ në Komision, se subjekti i rivlerësimit, pas shitjes së apartamentit në Shkodër, është transferuar së bashku me familjen në Durrës dhe ka jetuar jo në një banesë të tijën deri në vitin 2006, duke bërë të besueshme nevojën për shitjen e pajisjeve shtëpiake, në të njëjtën kohë me shitjen e apartamentit në Shkodër. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se si kursime të subjektit të rivlerësimit, në *cash*, në fund të vitit 2003, duhet të konsiderohet shuma prej 2.200.000 lekësh, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën e vitit 2003, shumë që ka shërbyer si burim krijimi për pagesën e kështit të parë për blerjen e pasurisë së apartamentit në Durrës.

25. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se, *si burime të ligjshme për shlyerjen e pagesave të apartamentit gjatë vitit 2006, duhet të konsiderohen, përveç shumës 1.900.000 lekë, edhe tërheqjet në cash nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur nga data 01.01.2006 - 21.08.2006, që në total rezultojnë të jenë në shumën 1.022.152 lekë, trupi gjykues vëren si vijon.*

25.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pagesën e shumës 25.000 euro, ndër të tjera edhe *kursimet ndër vite*, deri në vitin 2006.

25.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se për periudhën 2003-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar posedimin e kursimeve *cash* në vlerën 2.200.000 lekë, vetëm në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ndërsa në vitet 2004, 2005 dhe 2006, nuk rezulton të ketë deklaruar kursime në *cash*, të krijuara në fund të secilit vit, në formularët përkatës.

25.3 Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozituar me afat 3-mujor, 7.000 USD, në Raiffeisen Bank, datë 19.07.2005, nr. i llogarisë {***}*. Sipas të dhënave mbi llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë kësaj banke¹⁵, rezulton se më datë 19.07.2005, ai ka çelur një depozitë bankare 3-mujore, në shumën 7.000 USD. Depozita rezulton të jetë mbyllur më datë 02.05.2006, pasi shuma prej 7.000 USD është tërhequr prej tij në të njëjtën datë, duke përfituar dhe interesat e depozitës, në shumën 11.152 lekë.

25.4 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit drejtuar më datë 13.11.2019, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e përcjella në Komision, lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite bankare, ka deklaruar se *kjo shumë është pjesë e të ardhurave nga shitja e shtëpisë në Shkodër. Paratë e shitjes së shtëpisë, si dhe të shitjes së mobilieve janë këmbyer në dollarë dhe duke mos pasur akoma një kontratë sipërmarrjeje për banesën personale, ua kam dhënë hua njerëzve të mi. Në korrik të vitit 2005 më kthyen huan prej 7.000 dollarësh, që është pjesë e çmimit total të shitjes së shtëpisë time. Këtë shumë, për të mos e mbajtur në shtëpi, e kam derdhur në llogari bankare.*

¹⁴ Neni 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil, parashikon se: “Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë”.

¹⁵ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.01.2019.

25.5 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar të përcjellë nga institucionet bankare në Komision, mbi gjendjen e likuiditeteve bankare për periudhën e referuar nga Komisioneri Publik, rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë 07.08.2006, ka depozituar *cash* në llogarinë në emër të Ludovik ose M. Dodaj, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, shumën 16.000 USD, të cilën e ka tërhequr një ditë më pas, më datë 08.08.2006. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, në pyetësorin drejtuar subjektit të rivlerësimit më datë 13.11.2019, i ka drejtuar pyetje, lidhur me burimin e krijimit të këtij depozitimi bankar në *cash*. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e përcjella në Komision, ka deklaruar se *kjo shumë është nga shitja e shtëpisë në Shkodër, të cilën e kam konvertuar në dollarë. Siç e shpjegova më lart, kur të afërmit e mi më kthyen paratë pjesë-pjesë, për të mos i mbajtur në shtëpi, i kam depozituar në bankë. Janë gjithmonë paratë e shitjes së shtëpisë, kontratën e së cilës e kam deklaruar.*

26. Në analizë të situatës faktike të pasqyruar në paragrafët më sipër, në raport me pretendimet e Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton se shumat prej 7.000 USD dhe 16.000 USD, të tërhequra në *cash* nga llogaritë bankare nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, kanë si burim krijimi¹⁶ shumën prej 2.200.000 lekësh, e përfituar nga kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2003, së apartamentit në Shkodër dhe e deklaruar në *cash* nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003. Për rrjedhojë, në vijim të konkluzionit të arritur në paragrafin 21, më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se në kushtet kur ka konsideruar se shuma prej 2.200.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në Shkodër dhe e deklaruar si kursim në *cash* nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2003, ka shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurisë apartament në Durrës, konsiderimi i tërheqjeve në *cash* nga depozitat bankare, do të sillte një rritje artificiale të të ardhurave, duke qenë se, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, depozitimet dhe tërheqjet nga bankat janë para që rrjedhin nga shuma prej 2.200.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në Shkodër, e cila ka qarkulluar me hyrje dhe dalje nga sistemi bankar, në periudha të ndryshme gjatë viteve 2005 e 2006. Në përmbledhje të këtij arsytimi, trupi gjykues vlerësoi se në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të duhet të përlllogariten si burime për krijimin e shumës prej 25.000 eurosh, të paguar për blerjen e apartamentit në Durrës gjatë vitit 2006, do të konsiderohen vetëm interesat bankarë të përfituar nga depozitimi i shumës 7.000 USD në depozitë me afat, në Raiffeisen Bank, për periudhën 19.07.2005 - 02.06.2006, pasi shuma prej 16.000 USD nuk ka prodhuar interesa, për shkak të depozitimit në sistemin bankar për një kohë shumë të shkurtër, vetëm një ditë.
27. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se shumës në *cash* prej 2.200.000 lekësh, duhet t'i shtohen edhe kursimet e viteve 2004 dhe 2005, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të apartamentit, të cilat kanë qenë në shumën rreth 400.000 lekë gjatë vitit 2004 dhe rreth 500.000 lekë gjatë vitit 2005, ashtu siç janë deklaruar në procesverbalin e mbajtur nga inspektorët e ILDKPKI-së më datë 08.04.2016, trupi

¹⁶ Deri në datën 07.08.2006, datë e depozitimit në *cash* në BKT, të shumës prej 16.000 USD, subjekti i rivlerësimit, sipas deklarimeve dhe provave të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, kishte paguar 15.000 euro ose 1.850.250 lekë, për blerjen e apartamentit në Durrës, me burim të deklaruar paratë *cash* nga shitja e apartamentit në Shkodër, në shumën 2.200.000 lekë (të cilat, sipas kursit të këmbimit të datës 01.01.2006, konvertohen në 22.680 USD.) Pra, nga shuma e përfituar nga shitja e shtëpisë në Shkodër, subjektit nuk i kishin mbetur vlera monetare të mjaftueshme për të depozituar në bankë shumën prej 16.000 USD. Në këto kushte, shuma prej 16.000 USD, e depozituar në BKT, në datë 07.08.2006, nuk mund të kishte si burim krijimi paratë *cash* të përfituara nga shitja e apartamentit në Shkodër.

grykues vlerëson të theksojë se si zyrtar deklarues pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, në zbatim të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar¹⁷, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte kursimet *cash*, të krijuara në vitin përkatës. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaramit*. Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave për vitet 2004 e 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa të kursimeve në *cash* të deklaruara në vitin 2003, në zbatim të detyrimeve të sipërcituara. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, por edhe i akteve të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, nuk rezulton të jetë administruar akti “procesverbal i mbajtur nga inspektorët e ILDKPKI-së më datë 08.04.2016”, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për sa më sipër, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Durrës, kanë shërbyer ndër të tjera dhe [...] kursimet ndër vite deri në 2006, nuk përputhet me deklaramet periodike. Për këto arsye, në konkluzion të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se argumentimi i subjektit të rivlerësimit nuk është bindës dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë.

28. Në funksion të arsytimit të shtjelluar në paragrafët më sipër në këtë vendim, në lidhje me shumat e konsideruara se përbëjnë burimin e krijimit të shumës objekt verifikimi dhe analize, trupi gjykues verifikoi mundësinë reale të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesën e këstit të parë në shumën 25.000 euro [ose 3.074.750 lekë¹⁸] për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se për periudhën 01.01.2006 deri më datë 21.08.2006, datë në të cilën është likuiduar tërësisht shuma prej 25.000 eurosh¹⁹, pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit, rezulton në vlerën negative prej 163.959 lekësh. Trupi gjykues konstaton se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në nivelin e përlllogaritur nga Komisioneri Publik, rezulton e konfirmuar.
29. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesën e shumës 4.000 euro për shlyerjen e këstit të apartamentit në Durrës, në vitin 2008, ashtu siç ka konstatuar edhe Komisioni, për një diferencë negative prej 358.816 lekësh, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se: *Nga analiza financiare e kryer për vitet 2006 - 2012, pasqyruar në tabelën e mëposhtme, subjekti rezulton me mungesë mjetesh financiare në shumën 358.816 lekë, për vitin 2008. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, çmon se, nisur nga vlera e këtyre shpenzimeve, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre shpenzimeve të pambuluara, në raport me provat e tjera të administruara nga*

¹⁷ Neni 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, parashikon: “[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”

¹⁸ Përlllogaritur sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën e kryerjes së pagesave, sipas të cilit 1 euro = 123,95 lekë.

¹⁹ Sipas mandateve të arkëtimit të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të konfirmuara nga shoqëria “{***}” ShPK, ai ka paguar kundrejt shoqërisë së sipërcituar, shumën prej 5.000 eurosh më datë 07.01.2006; shumën prej 10.000 eurosh më datë 26.05.2006, si dhe shumën prej 10.000 eurosh më datë 21.08.2006.

Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se balanca negative në vitin 2008, nuk mund të shërbejë si shkak i vetëm për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61.

30. Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se diferenca negative e analizës së vitit 2008, e konstatuar nga Komisioni, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, thëllon pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003-2016.
31. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka prapësuar se pretendimi Komisionerit Publik nuk qëndron, pasi në deklarinë e kursimeve të vitit 2008 në shumën 550.000 lekë, duke pasur perceptim të gabuar për mënyrën se si deklarohen kursimet, ka deklaruar si kursim gjithsej paratë në *cash* në banesë, prej 350.000 lekësh, dhe gjendjen e bankës prej 200.000 lekësh në llogari bankare. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse kursimet në *cash* përlllogariten në shumën 350.000 lekë, analiza financiare për vitin 2008, rezulton në vlerë negative në një vlerë të papërfillshme.
32. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtesë në para të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 550.000 lekë.* Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffeissen, rezulton se gjendja e likuiditetit, në datë 31.12.2008, është në vlerën 195.199 lekë, ndërsa nga llogaria bankare e bashkëshortes në bankën Intesa San Paolo, rezulton se gjendja e likuiditetit, më datë 31.12.2008, është në vlerën 334 lekë.
Trupi gjykues vëren se, mbështetur në parashikimet e nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, lidhur me detyrimin për të deklaruar “[...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte gjendjen reale të likuiditeteve në *cash* deri më datë 31.12.2008, të veçuar nga deklarimi për gjendjen e likuiditeteve bankare, për të njëjtën periudhë²⁰. Mënyra e deklarimit të kryer prej subjektit të rivlerësimit, jo vetëm nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, por nuk rezulton të jetë korrigjuar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore vijuese. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë si kursim në *cash* për vitin 2008, shumën prej 550.000 lekësh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se nga verifikimi i deklaratave periodike të viteve vijuese, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë konsekuente, kursimet vjetore i ka deklaruar si shtesa në para, në mënyrë të njëjtë me deklarimin e vitit 2008. Duke qenë se subjekti ka pretenduar se kjo mënyrë deklarimi ka ardhur si pasojë e perceptimit të gabuar për mënyrën se si deklarohen kursimet, atëherë logjikisht do të duhej që pretendimin mbi mënyrën e llogaritjes së kursimeve në *cash*, ai ta kishte shtrirë edhe për vitet në vijim, si rezultat i të cilit kursimet në *cash* do të rezultonin në vlera më të vogla sesa ato të deklaruara. Në mungesë të ngritjes së një pretendimi të tillë për vitet vijuese, trupi gjykues çmoi

²⁰ Në formularin e deklaratës së pasurisë, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë “Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, të vitit 2008, kërkohet nga deklaruesit: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë, që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes [...] pjesën takuese që zotëroni për çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara apo jo në regjistra publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”.

se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vjen si artificë për të shmangur rezultatin negativ të analizës financiare për vitin 2008, dhe jo si një mënyrë perceptimi e detyrimit për deklaram.

33. Nga rezultati i analizës financiare të kryer në Kolegj për vitin 2008, në mbështetje të arsytimit të mësipërm, konfirmohet balanca negative prej 358.816 lekësh, e konstatuar nga Komisioni dhe e pretenduar nga Komisioneri Publik. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik është i bazuar dhe diferenca negative e konstatuar do të analizohet së bashku me konkluzionet e tjera të arritura në këtë vendim, lidhur me vlerësimin e pasurisë apartament në Durrës.
34. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se *subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme huan e deklaruar dhe, rrjedhimisht, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e parakohshme të kredisë, si dhe shlyerjen e këstit të apartamentit, në vitin 2009, për një diferencë negative më së paku prej 1.007.760 lekësh*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim²¹, në lidhje me këtë hua, ka arritur në konkluzionin: *Subjekti i rivlerësimit, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, ka depozituar dokumentet “Shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat e personave fizikë, në bazë të deklaramit fillestar” të z. A. D., për periudhën 2005-2014. Bazuar në këtë dokumentacion, rezulton se kunati i subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2005-2009, ka krijuar të ardhura në shumën 54.413 euro, të cilat janë të mjaftueshme për dhënien e huas 8.000 euro.*
35. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe atyre të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstaton si vijon.

35.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar si burim të pagimit të këstit prej 4.000 eurosh, për apartamentin në Durrës, në vitin 2009, huan e marrë nga vëllai i bashkëshortes, në shumën 8.000 euro. Gjithashtu, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të këtij formulari, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë huaje me kunatin tim, z. A. D., në shumën 8.000 euro, e marrë në vitin 2009 për të shlyer kredinë e vitit 2006. Kontrata është lidhur verbalisht pa ndonjë formë të caktuar sipas ligjit, duke qenë se ishim në marrëdhëniet e mirëbesimit. Z. A. D. jeton në shtetin e Greqisë që prej vitit 1994 me familjen, me rezidencë aktuale në {***} dhe me të ardhura nga të dy bashkëshortët. Informacioni për këtë person në lidhje me të ardhurat dhe banimin është depozituar pranë ILDKPKI, më datë 8 prill 2016.*

35.2 Marrja e huas nga z. A.D. është deklaruar në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, në të cilën, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera: *8.000 euro hua të marra kunatit (vëllait të bashkëshortes), A. L. D., me banim në {***}, Greqi.*

35.3 Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga Komisioni më datë 13.11.2019: *Shuma prej 840.732 lekësh buron nga kontrata e huas që kam bërë me kunatin tim, z. A. D., në shumën 8.000 euro, pikërisht për të shlyer këtë kredi.*

²¹ Paragrafi 26.13 i vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit.

35.4 Nga të dhënat bankare të përcjella në Komision nga Banka Kombëtare Tregtare²², rezulton se subjekti i rivlerësimit, me anë të kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2006, ka marrë kredi në shumën 1.200.000 lekë, me objekt *rikonstruksion banese*. Kjo është kredi është shlyer tërësisht më datë 03.02.2009, me derdhjen e shumës prej 840.732 lekësh për mbylljen e saj.

35.5 Sipas të dhënave të mandatarkëtimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se kësti i apartamentit në shumën 4.000 euro, është paguar prej tij më datë 16.09.2009.

35.6 Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, z. A. L. D., subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, formularët “Shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat e personave fizikë, në bazë të deklaramit fillestar” të z. A. D.²³ dhe bashkëshortes së tij, znj. L. D., për periudhën 2005-2014, të përkthyer në gjuhën shqipe²⁴. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, në linjë me qëllimin e sipërcituar, paraqiti:

- “Njoftim i likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë me bazë deklaramit fillestar” për vitin financiar 2004 - printim nga sistemi informativ i Ministrisë së Financave të Greqisë, datë 04.04.2022, për të tatuarin A. L. D., pajisur me vulë apostile, lëshuar në {***}, në datë 20.04.2022, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- “Deklarim i tatimit mbi të ardhurat e vitit financiar 2004 - printim nga sistemi, Institucioni Publik Financiar {***}, datë 04.04.2022, për tatimpaguesin A. L. D., pajisur me vulë apostile, lëshuar në {***}, në datë 20.04.2022, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- “Deklarim i tatimit mbi të ardhurat e vitit financiar 2003” - printim nga sistemi, Institucioni Publik Financiar {***}, datë 04.04.2022, për tatimpaguesin A. L. D., pajisur me vulë Apostile lëshuar në {***}, në datë 20.04.2022, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- “Deklarim i tatimit mbi të ardhurat e vitit financiar 2003” - printim nga sistemi, Institucioni Publik Financiar {***}, datë 04.04.2022, për tatimpaguesin A. L. D., pajisur me vulë apostile, lëshuar në {***}, në datë 20.04.2022, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- “Deklarimi fillestar për vitin 2003” - printim nga sistemi, Institucioni Publik Financiar {***}, datë 20.04.2022, për tatimpaguesin A. L. D., pajisur me vulë apostile, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- “Formular 3 - Vërtetim A” i Ministrisë së Punës së Greqisë, për A. L. D., datë 13.05.1998, dokument origjinal, përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

- Akt lindjeje, datë 25.04.2000 me vulë origjinale dhe nënshkrim origjinal datë 12.09.2005, i fëmijës K. D., përkthyer nga greqishtja në shqip nga përkthyes zyrtares E. M., me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 30.05.2022.

²² Informacion i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2019.

²³ Në formularët “Shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat e personave fizikë në bazë të deklaramit fillestar” të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës së shtetit grek, emri i shënuar është A. L. D..

²⁴ Përkthyer nga përkthyesja ligjore Ioana Maro, sipas të dhënave të vulës së përkthyesit.

36. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, të pasqyruara në paragrafët më sipër të këtij vendimi, në raport me konkluzionin e Komisionit dhe situatën faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht neneve 1050-1055, veprimi juridik i huas përfshihet te kontrata joformale. Gjithashtu vetë neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*, duke pranuar se marrëdhëniet e pretenduara sipas kësaj dispozite, jo detyrimisht duhet të jenë të formalizuara në një formë të caktuar [përveç rastit kur forma e tyre është e detyrueshme për vlefshmërinë e tyre, sipas përcaktimit të Kodit Civil], për sa kohë që për provimin e ekzistencës së tyre, në procesin e rivlerësimit, kërkohet konfirmimi i personit tjetër të lidhur. Duke konsideruar dhe marrëdhënien e posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe z. A.D., të cilët rezultojnë të jenë në lidhje familjare, trupi gjykues beson ekzistencën e marrëdhënies së huas, pavarësisht mungesës së formalizimit të saj, edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e saj në deklaratën e interesave të vitit 2009, si dhe në deklaratimet periodike të viteve 2010, 2011 dhe 2013, shlyerjen e saj. Gjithashtu, fakti që personi tjetër i lidhur, z. A.D., është treguar aktiv gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e tij, çmohet nga trupi gjykues se përmbush kriterin e konfirmimit të kësaj marrëdhënieje sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
37. Trupi gjykues shqyrtoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat u mbështetën në paraqitjen e të ardhurave të ligjshme të siguruara nga puna e z. A.D. në Greqi dhe dokumentacionin shoqëruar që provon këtë fakt, të sjellë në cilësinë e provës gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, në seancën gjyqësore publike të datës 07.06.2022. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegj, rezultoi se z. A.D. ka jetuar si emigrant në Greqi që prej vitit 1998. Për të provuar të ardhurat e realizuara në vite nga puna e personit tjetër të lidhur në këtë shtet, janë paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, *deklarimet e tatimit mbi të ardhurat e vitit financiar* për periudhën 2003-2014, të lëshuara nga institucioni përgjegjës për tatimet, i shtetit grek. Bazuar në këtë dokumentacion provues, trupi gjykues përcaktoi se vlera e të ardhurave të ligjshme të krijuara prej personit tjetër të lidhur, përgjatë periudhës 2003 deri më 31.01.2009, është në vlerën prej 58.412 eurosh, ndërsa për periudhën shkurt 2009 - gusht 2009 është në vlerën prej 6.636 eurosh, pasi këto janë të ardhurat *neto*, të cilat kanë rezultuar nga të dhënat e formularëve përkatës, pas zbritjes së tatimit të paguar nga z. A.D dhe bashkëshortja e tij. Duke qenë se huaja është dhënë në vitin 2009, sipas prapësimet të subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, e ndarë në dy pjesë – 6.000 euro në fund të muajit janar dhe 2.000 euro në muajin gusht – periudha pas vitit 2009 ishte irelevante për të vlerësuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur. Trupi gjykues, gjithashtu, vlerësoi se vlera minimale për të jetuar në Greqi për personin tjetër të lidhur, bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij²⁵, për vitet 2003 - janar 2009, referuar të dhënave të gjendura në faqen zyrtare të statistikave *eurostat*, për kategorinë e shtetasve grekë në nivelin e

²⁵ Të dhënat për përbërjen familjare të z. A. D., rezultojnë nga të dhënat e pasqyruara në formularët e Deklarimit të tatimit mbi të ardhurat për secilin vit financiar të periudhës objekt shqyrtimi.

varfërisë²⁶, arrin në vlerën 73.426 euro, ndërsa për periudhën shkurt 2009 - gusht 2009 është në vlerën 8.449 euro.

38. Trupi gjykues vlerësoi situatën faktike të mësipërme, në kuadër të përcaktimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka barrën të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie e cila i dhurohet ose i jepet hua prej personit tjetër të lidhur, në këtë rast, të shumës prej 8.000 eurosh. Në kuptim të kësaj dispozite dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues mori në konsideratë faktin se përgjatë periudhës 2003 - 2009, e cila u shqyrtua bazuar në arsyetimin logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur, jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të tij, por aq sa është proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të vlerës prej 8.000 eurosh, objekt huaje. Trupi gjykues vlerësoi raportin që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se z. A.D. dhe bashkëshortja e tij kishin realizuar të ardhura prej ndonjë burimi tjetër të ligjshëm. Në këtë kuptim, për të verifikuar nëse shumën e dhënë hua fillimisht, prej 6.000 eurosh, z. A.D., kishte mundësinë ta ruante, trupi gjykues çmoi se nga shuma prej 58.412 eurosh që janë të ardhurat e ligjshme sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duhet të zbritet shuma prej 73.426 eurosh, e cila është shuma e analizuar si shpenzim jetik bazik për familjen e personit tjetër të lidhur, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë lloj dokumentacioni provues në kuadër të pretendimeve të tij se familja e z. A.D. nuk kishte pasur shpenzime jetike, pasi banonte në shtëpinë e familjes që i kishte punësuar, me ushqim dhe fjetje të siguruar nga kjo familje. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se personi tjetër i lidhur nuk kishte mundësi të kursente shumën prej 6.000 eurosh, pasi shpenzimet jetike tejkalojnë të ardhurat e realizuara, për periudhën 2003 - janar 2009. Bazuar në logjikën e mësipërme të arsyetimit, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion edhe për shumën 2.000 euro, se personi tjetër i lidhur nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, konkluzion i cili nuk kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të pasurive e kryerjes së shpenzimeve prej tij, e gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik, se huaja e dhënë subjektit të rivlerësimit, në shumën 8.000 euro, nuk përbën burim të ligjshëm për shlyerjen e parakohshme të kredisë në shumën 840.732 lekë, si dhe shlyerjen e këstit të apartamentit në shumën 4.000 euro [ose 534.640 lekë]²⁷, në vitin 2009, për një diferencë negative prej 1.007.760 lekësh.
39. Në konkluzion, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 108,48 m² në {***}, Durrës, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të kryer pagesat e kësteve për blerjen e pasurisë objekt kontrolli dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, në vitet 2006, 2008 dhe 2009, në shumën totale prej 1.530.535 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
40. Lidhur me shkaku e ankimit të Komisionerit Publik se *subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitet 2013 dhe 2014, për diferencat negative respektivisht 658.154 lekë dhe 649.771 lekë*, trupi gjykues konstatoi si vijon.

²⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>.

²⁷ Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 16.09.2009, datë e pagesës së këstit të apartamentit në Durrës.

41. Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se:

27.2 Subjekti i rivlerësimit në datën 26.11.2013, bazuar në faturën e shoqërisë “{***}”, ka blerë automjetin tip “Mercedes - Benz C200” për shumën 9.500 euro. Për këtë automjet, referuar deklaratës doganore “{***}” të datës 6.12.2013, është paguar detyrimi doganor në shumën 392.421 lekë.

27.3 Si burim për blerjen e këtij mjeti subjekti ka deklaruar:

i. Kredi në “Raiffeisen Bank” më 22.11.2013 në shumën 1.008.800 lekë. Në datën 22.11.2013, subjekti ka marrë kredi pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.008.800 lekë, me afat 60 muaj. Nga nxjerrja e llogarisë e subjektit në lekë, në “Raiffeisen Bank”, rezulton se:

- Kredia është disbursuar në datën 22.11.2013. Në po të njëjtën datë, subjekti ka tërhequr shumën 984.000 lekë.

- Subjekti, në datën 05.06.2014, ka likuiduar pjesërisht këtë kredi, duke paguar shumën 637.793 lekë. Kjo shumë është krijuar nga gjendja në llogari dhe një depozitim cash në shumën 430.000 lekë.

Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për likuidimin e kredisë në vitin 2014.

ii. Një pjesë është përfituar nga kontrata e shitblerjes së makinës së mëparshme “Benz 190” e prodhimit në vitin 1989, me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., e datës 18.10.2013, me çmimin 180.000 lekë. Ky mjet ishte blerë nga subjekti më datë 13.10.2004, me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., për shumën 200.000 lekë.

iii. Pjesa tjetër e pagesës së makinës është bërë nga kursimet.

27.4 Nga analiza financiare, konstatohet se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

42. Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet e referuara gjatë gjykimit në Kolegj, në kundërshtimin si të pabazuar të arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar se në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, Komisioni, për vitet 2013 dhe 2014, ka pakësuar kursimet në *cash*, të padeklaruara si pakësime nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore respektive. Sipas Komisionerit Publik, në analizën financiare të vitit 2013, Komisioni ka pakësuar kursimet në *cash* të viteve paraardhëse (2008-2012), në vlerën 560.416 lekë, ndërsa në vitin 2014, ka pakësuar kursimet në *cash* të viteve paraardhëse, në vlerën 700.550 lekë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, treguesit e analizës financiare të realizuar nga Komisioni, lidhur me gjendjen *cash*/kursimet ndër vite, duhej të bazoheshin vetëm mbi sa ka deklaruar vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave, për vitet përkatëse, si për shumën e deklaruara të kursyera, ashtu edhe për burimin e deklaruar. Në këto rrethana, Komisionerit Publik i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në këto vite, për diferencat negative respektivisht 658.154 lekë në vitin 2013 dhe 649.771 lekë në vitin 2014.

43. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik janë të pabazuara, pasi në lidhje me automjetin e blerë në vitin 2013, burimi i krijimit është deklaruar saktësisht prej tij, se një pjesë është nga kursimet e vitit, që do të thotë nga pakësimi i kursimeve në *cash*. Në këtë kuptim, për vitin 2013, ka deklaruar shtesë në para të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore dhe në të njëjtën kohë, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar se nga kursimet gjendje deri në fund të vitit 2012, ka shpenzuar një pjesë për blerjen e automjetit. Referuar dy deklaratave të sipërcituara, rezulton e qartë, sipas subjektit të rivlerësimit, se për vitin 2013, shtesa *neto* në kursime është 389.584 lekë,

pra 950.000 lekë shtesë nga kursimet e vitit, minus 560.416 lekë pakësim nga kursimet për blerjen e automjetit. Në deklaratën periodike të vitit 2014, nuk ka deklaruar shtesë kursimesh në *cash* dhe në kuptim të plotësisht të deklaratës, është mjaftuar vetëm me deklarimin e shpenzimeve dhe shtimin e ndonjë pasurie, duke nënkuptuar dhe pakësimin e kursimeve në *cash* për përbalimin e shpenzimit. Referuar analizës financiare dhe deklarimeve të tij, nuk rezulton që të ketë deklaruar përdorim tjetër të kësaj gjendje në *cash*, fakt që tregon qartësisht se kjo gjendje në *cash* është shpenzuar gjatë periudhës përpara vitit 2016. Konsumimi i gjendjes në *cash*, është bërë në ato vite kur ka pasur shpenzime apo shtim të pasurisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, pavarësisht ndonjë pasaktësie në deklaratat periodike për pakësimin e kursimeve në *cash*, këto rrethana nuk mund të justifikojnë dhënien e masës më të lartë disiplinore, atë të kërkuar nga Komisioneri Publik, të shkarkimit nga detyra, sipas kritereve të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016.

44. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në verifikim të rrethanave faktike të pretenduara nga Komisioneri Publik në këtë shkak ankimi, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.

44.1 Nga analizimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, rezulton që për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz C200”, subjekti ka deklaruar: “Automjet “Benz C Class 200”, viti i prodhimit 2010, i blerë në shtetin e Gjermanisë, me anë të kontratës së shitblerjes, në nëntor 2013. Mbi këtë automjet është paguar dogana në vlerën 392.421 lekë. Për blerjen e këtij automjeti, është marrë një kredi në Bankën Raiffeisen, në datë 22.11.2013, në shumën 1.008.800 lekë. Një pjesë tjetër është përfituar nga kontrata e shitblerjes së makinës së mëparshme “Benz 190”, vit prodhimi 1989, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2013, me çmim 180.000 lekë. Pjesa tjetër e pagesës së makinës është bërë nga kursimet. Vlera 9.500 euro, plus 392.421 lekë dogana”. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë kredie në datë 22.11.2013, e marrë nga Raiffeisen Bank, në shumën 1.008.800 lekë. Objekti i marrjes së kredisë është për qëllim personal, ku konkretisht e kam përdorur për blerjen e automjetit që disponoj edhe aktualisht. [...] Në qershor të vitit 2014, është paguar një shumë prej 600.000 lekësh, shumë e siguruar nga kursimet”.

44.2 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore, në periudhën 2003-2007, nuk ka deklaruar posedimin e kursimeve në *cash*, të krijuara për secilin vit.

- Në deklaratën e interesave të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 550.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2009, ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2010, ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2011, ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2012, ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 800.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2013, ka deklaruar: “Shtesë në para, të siguruara nga kursimet e të ardhurave vjetore. Vlera 950.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Në deklaratën e interesave të viteve 2014 dhe 2015, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të kursimeve në *cash*.

- Në deklaratën e interesave të vitit 2016, ka deklaruar: “Kursim nga pagat për vitin 2016. Vlera 150.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

Sipas deklarimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2016, duhet të dispononte gjendje në *cash* kumulative në shumën 3.900.000 lekë.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje kursimesh në *cash*.

44.3 Në deklaratën e interesave të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz C200” në vlerë totale prej 12.300 eurosh; në vitin 2014, ka deklaruar shlyerjen e pjesëshme të kredisë në vlerën 637.793 lekë dhe pagesën e studimeve të doktoratës së vajzës së tij, në shumën 5.000 euro. Për shpenzimet e cituara më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e financimit të tyre në deklaratat periodike përkatëse.

45. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi që thelbi i kundërshtimit të Komisionerit Publik lidhet me faktin se subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve në *cash* si burim për krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve dhe, për këtë arsye, Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji, që në analizën financiare për vitin 2013 dhe vitin 2014, të mos pakësohet zëri i kursimeve të akumuluar në vite, por pasuritë dhe shpenzimet të konsiderohen të mbuluara nga pakësimi i të ardhurave vjetore.

Në vijim të sa më sipër, si dhe të rrethanave faktike mbi deklaratat e subjektit në deklaratat periodike e në atë të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi fillimisht se në kuadër të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), si dhe kërkesave të formularit të deklarimit të interesave private, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që për çdo vit të deklaronte krahas pasurive të krijuara, edhe burimin e krijimit të tyre. Ky detyrim nuk është përmbushur në mënyrë konsekuente nga subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratat periodike vjetore, por vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Trupi gjykues çmoi se deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit. Këtë cilësim ua njeh vetë ligji i posaçëm nr. 84/2016 në nenin 32, pika 5 e tij, për të provuar nëpërmjet tyre, deklaratat e bëra në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasuritë e deklaruara dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të tyre²⁸.

Në këtë kuptim, e gjithë situata e mosdeklarimit të burimeve të krijimit të pasurive apo burimit të mbulimit të shpenzimeve në deklaratat periodike të interesave, pavarësisht se nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin në kuptim të procesit të rivlerësimit dhe të vendosjes së masës disiplinore në ngarkim të tij, u vlerësua nga trupi gjykues se afekton procesin e kontrollit të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kushtet kur objekt i kontrollit janë kursimet në *cash*, të përdorura si burim krijimi i pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve, kursime të cilat prezumoheshin për shkak të ligjit se duhej të mbështeteshin e provoheshin me anë të deklarimeve në deklaratat periodike, pasi për shkak të specifikës së tyre, ato nuk mund të verifikohen me dokumentacion tjetër provues.

Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, objekt i

²⁸ Në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit në vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018 (JR), nr. 8/2018 (JR), nr. 9/2018 (JR), nr. 10/2018 (JR), nr. 12/2018 (JR), nr. 9/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR).

kontrollit janë pasuritë për të cilat subjekti mbarte detyrimin për t'i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe që janë relevante në këtë proces dhe kontrolli fillon nga verifikimi i deklaratave të subjektit në të, një qëndrim tashmë i konsoliduar ky në jurisprudencën e Kolegjit²⁹. Në këtë kuptim, si dhe në kushtet kur Komisioneri Publik nuk pretendoi për sjellje të subjektit e cila, nëpërmjet mosdeklarimit të burimeve të krijimit të pasurive e mbulimit të shpenzimeve në deklaratat periodike, të ketë synuar fshehjen e ndonjë marrëdhënieje pasurore ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, çka do të përbënte rrethanë që duhej vlerësuar e analizuar nga Kolegji në mënyrë të posaçme, trupi gjykues vlerësoi se burimet e krijimit të pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve nga subjekti i rivlerësimit, duhet të verifikohen e kontrollohen sipas atyre që janë deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

46. Në vijim, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, për vitet 2013 dhe 2014, rezultoi se nga gjendjet e parave *cash* të akumuluar në vitet paraardhëse, janë zbritur, përkatësisht për vitin 2013, pagesat e kryera për blerjen e pasurisë automjet “Mercedes Benz C200” dhe pagimi i taksës së regjistrimit të pronësisë së apartamentit me sipërfaqe 108,48 m² në Durrës, ndërsa për vitin 2014, pagimi i studimeve të doktoratës së znj. B. D. dhe shlyerja e një pjese të kredisë së marrë në Raiffeisen Bank.

Lidhur me shpenzimet e kryera për pagesën e doktoratës së vajzës së tij në vitin 2014, në shumën 5.000 euro ose 702.500 lekë³⁰, trupi gjykues konstatoi se burimi për financimin e tyre nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimin periodik vjetor të vitit 2014. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Vajza B. D. ka vazhduar studimet pasuniversitare doktoraturë nga 2014 e deri më sot, në Universitetin Europian të Tiranës. Është paguar shuma totale 5.000 euro për tri vite [...], shumë e cila është marrë nga të ardhurat e familjes.* Bazuar në këtë situatë faktike, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerësoi se shpenzimet e arsimimit të vajzës së tij, në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk i ka përballuar me kursimet e akumuluar në vite.

47. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji në mbështetje të arsytimit si më sipër, duke konsideruar si pakësim të gjendjes së kursimeve në *cash* të akumuluar në vite, shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, me burim të identifikuar nga kursimet në vite, rezultoi se për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit nuk justifikonte me burime të ligjshme krijimin e pasurisë automjet “Mercedes Benz C200” dhe pagimin e taksës së regjistrimit të pronësisë së apartamentit me sipërfaqe 108,48 m² në Durrës, si dhe shpenzimet e tjera, në shumën 122.538 lekë. Ky rezultat i analizës financiare, megjithëse i kryer mbi premisat e njëjta të pakësimit të kursimeve të akumuluar në *cash* nga vitet e mëparshme për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, ndryshon nga ai i Komisionit, pasi:

Së pari: Vendimi i Komisionit nuk referon mbi rezultatin e analizës financiare për vitin 2013, por në analizën financiare, e cila i është bërë e njohur subjektit të rivlerësimit si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ, për vitin 2013, rezultoi balanca negative në vlerën 97.738 lekë.

Së dyti: Në analizën e sipërcituar, Komisioni ka përllogaritur si të ardhur, e cila ka shërbyer për financimin e një pjese të shumës së paguar për blerjen e automjetit, të gjithë vlerën e kredisë së disbursuar në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank, më datë 22.11.2013, në shumën totale prej 1.008.800 lekësh, ndërsa në analizën financiare të kryer në Kolegji, kjo e ardhur është përllogaritur

²⁹ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021; vendimi nr. 2/2022, datë 15.02.2022 etj.

³⁰ Llogaritur me kursin e këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë, në datën e kryerjes së pagesës, sipas të cilit 1 euro = 140,5 lekë.

në shumën 984.000 lekë, aq sa subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga shuma e disbursuar e kredisë, siç rezulton nga të dhënat e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank³¹.

Për vitin 2014, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk justifikonte me burime të ligjshme shlyerjen e pjeshme të kredisë në Raiffeisen Bank dhe pagesën e studimeve të doktoratës së vajzës së tij, si dhe shpenzimet e tjera, në shumën 51.722 lekë. Në vijim të arsyetimit si më sipër, trupi gjykues nënvizon se ky rezultat është i ndryshëm nga ai i konstatuar në analizën financiare, pjesë e rezultateve të hetimit administrativ të kryer në Komision, sipas të cilit balanca pozitive e vitit është në vlerën 50.779 lekë, për shkak se në ndryshim nga Komisioni, nuk është konsideruar si pakësim i kursimeve të akumuluar në *cash*, në vite, pagesa e kryer për arsimimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, në shumën 5.000 euro, por është pakësuar vetëm vlera prej 600.000 lekësh, si pagesë për shlyerjen e pjeshme të kredisë në Raiffeisen Bank, në përputhje me deklarin e subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit³².

Sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik është i bazuar.

48. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me kryerjen e pagesave të kësteve për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 108,48 m², në Durrës, e kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2008 dhe 2009, si dhe për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitet 2013 dhe 2014, rezultoi në shumën totale 1.704.795 lekë. Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme rezultoi në një nivel të pajustificueshëm, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e deklarinimit të pamjaftueshëm për këtë kriter vlerësimi, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me pretendimet sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

49. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit duheshin vlerësuar në raport me etikën e subjektit dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, referuar kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016*, trupi gjykues, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi si vijon.
50. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni më datë 13.11.2019, kërkesës: “Ju keni blerë shtëpi në vitin 2006. [...] informoni se ku keni qëndruar deri në momentin e blerjes së shtëpisë, duke na vënë në dispozicion dokumentacionin provues”, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Nga muaji shtator i vitit 2002 deri në qershor 2003, kam qëndruar në banesën në pronësi të z. N. Gj.. Pronari i kësaj pasurie më ka lënë në përdorim*

³¹ Nga të dhënat e llogarisë bankare nr. {***}, të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, rezulton se në këtë llogari, më datë 22.11.2013, është disbursuar kredia në shumën 1.008.800 lekë, nga të cilat, në të njëjtën datë, është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit, shuma prej 984.000 lekësh.

³² Komisioni, në analizën financiare pjesë e rezultateve të hetimit administrativ, për vitin 2014, ka pakësuar nga kursimet e akumuluar në *cash* të subjektit të rivlerësimit, vetëm shumën 700.550 lekë, të shpenzuar për pagesën e studimeve të doktoratës së vajzës së tij, ndërsa shumën e paguar për shlyerjen e pjeshme të kredisë e ka konsideruar të realizuar me të ardhurat e vitit.

*(huapërdorje) pa kundërshtëpërblim këtë pasuri, përkohësisht, për aq sa unë të zgjidhja pjesën e banimit për familjen. Shtetasi N. Gj. është i zonës sime dhe kemi njohje familjare të hershme dhe më ka ofruar ndihmën e tij vetëm për këtë shkak. Në dispozicion ju vë deklaratën nga ana e bashkëshortes së tij. Ndërsa, nga qershori i vitit 2003 deri në nëntorin e vitit 2006, kam banuar në shtëpinë e z. Ll. K., e regjistruar në zonën kadastrale ZK {***}, me numër pasurie {***}, apartament, në lagjen nr. {***}, rruga “{***}”, Durrës. Në këtë banesë kam qëndruar pa kundërshtëpërblim, pasi me këtë person kishim njohje familjare dhe, duke ditur pamundësinë time për të blerë menjëherë shtëpi në Durrës, më ka mundësuar të strehohem me familjen, deri në momentin që unë do të blija apartamentin tim.*

Bashkëlidhur përgjigjes së sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin në vijim:

50.1 Deklaratë e bashkëshortes së z. N. Gj., znj. D. Gj., e datës 18.11.2019, e cila deklaron se: “Unë dhe bashkëshorti im jemi pronarë të një shtëpie banimi dykatëshe me çati, plus papafingo, në lagjen nr. {***}, {***}, Durrës. Në periudhën shtator 2002 - qershor 2003, katin e dytë ia kemi lënë në përdorim, pa kundërshtëpërblim, shtetasit Ludovik Dodaj. Ky person është i njohur i familjes sonë, nga i njëjti vend i origjinës me ne, të cilin kemi dashur ta ndihmojmë për strehimin e përkohshëm të tij, duke qenë se sapo kishte ardhur nga Shkodra dhe nuk kishte banesë të tij në Durrës”.

50.2 Deklaratën e z. Ll. K., të datës 18.11.2019, i cili deklaron se: “Unë kam qenë pronar i pasurisë me nr. {***}, në ZK {***}. Në periudhën kohore qershor 2003 - nëntor 2006, këtë shtëpi ia kam lënë në përdorim, pa kundërshtëpërblim, shtetasit Ludovik Dodaj. Ky person për mua ka qenë mik i familjes, të cilin kam dashur ta ndihmoj për strehimin e tij, në atë kohë që nuk kishte banesë”.

50.3 Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë “apartament”, në pronësi të z. Ll. K., me sipërfaqe 154 m², me nr. pasurie {***} dhe adresë: rruga “{***}”, lagjja nr. {***}, Durrës.

51. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.12.2019, i ka drejtuar kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lidhur me çdo procedim penal dhe çdo dënim penal në ngarkim të shtetasit N. N. Gj.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.12.2019, ka informuar Komisionin se, pas verifikimeve të kryera në Zyrën e Regjistrimit, nuk ka të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit N. N. Gj..

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.01.2020, ka informuar Komisionin se: *në ngarkim të N. N. Gj., më datë 10.11.2011, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për nenin 283/2 të Kodit Penal. Dosja është pezulluar më datë 19.03.2012 për moszbulim të autorit të krimit dhe është dërguar pranë kartotekës së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.*

52. Në dosjen e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj për efekt të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, gjendet vendimi nr. {***}, datë 04.12.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së

Lartë, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, kundër të gjykuarit Ll. K., i cili referon se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 2.10.2009 ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit Ll. K., për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe, në bazë të neneve 248 e 49 të Kodit Penal, e dënon me 19 muaj burgim e 400 mijë lekë gjobë. Pushimin e çështjes penale për të pandehurin Ll. K., për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, në zbatim të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale. I pandehuri Ll. K. ka qëndruar në dhomat e paraburgimit me masën e sigurimit “Arrest në burg”, nga data 11.3.2008 deri më 1.4.2008 dhe më pas kësaj date, është me masë siguri “Arrest në shtëpi”. Gjoha të paguhet në katër këste, brenda një viti nga marrja formë të prerë të vendimit.*

- Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2011, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me të pandehurin Ll. K..*

Sipas përmbajtjes së këtij vendimi në datën 07.09.2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka filluar procedimin penal nr. {***}, për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” e “Falsifikimit të dokumenteve” sipas neneve 248, 258 e 186/2 të Kodit Penal në ngarkim të të gjykuarve Ll. K. etj.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 04.12.2013, të sipërcituar, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 16.11.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës.

53. Komisioneri Publik, në ankim, ka pretenduar se gjatë hetimit administrativ të Komisionit, përtej administrimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton të jenë administruar akte procedurale [vendime gjyqësore/ankim/rekurs etj.] ose korrespondencë me institucionet përkatëse, për të vërtetuar qenien e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të akuzës, gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit Durrës, të kërkesave gjatë hetimit të çështjes penale, si caktimi i masës së sigurisë etj., ose themelit të saj, në ngarkim të të pandehurit Ll. K.. Sipas Komisionerit Publik, hetimi i këtyre rrethanave, sikundër është kryer nga Komisioni në rastin e shtetasit N. Gj., do të mundësonte një vlerësim të plotë mbi etikën dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, elementet e mësipërme duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektit Ludovik Dodaj, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

54. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, në raport me konkluzionin e Komisionit dhe situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, shkakun e ankimit e ka orientuar në drejtim të vlerësimit të plotë mbi etikën dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, e cila parashikon se: *Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i*

kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin se nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakt me shtetasin Ll. K. pas vitit 2006, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, por nuk ka referuar se cilët kanë qenë hapat proceduralë dhe mjetet e kërkimit të provës, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të cilët e kanë orientuar drejt arritjes së përfundimit të mësipërm, madje subjektit të rivlerësimit nuk rezulton t'i jetë kaluar barrë prove në rezultatet e hetimit administrativ, pasi Komisioni që në këtë fazë të hetimit ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur kontakte me shtetasit N. Gj. dhe Ll. K., në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

55. Akti i vetëm, që referon të dhëna lidhur me shtetasin Ll. K., është vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 04.12.2013, por nga verifikimi i akteve e dosjes së rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, trupi gjykues nuk arriti të identifikojë hapat proceduralë të ndjekur nga Komisioni për administrimin e këtij vendimi.
56. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik, në lidhje me këtë shkak ankimi, duke parashtruar se: *Për të provuar të kundërtën për sa dyshohet, për të shmangur çdo ide që mund të çojë te konflikti i interesit, parashikuar nga pika 4 e nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, u angazhova me nxjerrjen e vendimeve që disponohen për shtetasin Ll. K., në mënyrë që ta pasqyroj pastërtinë e figurës sime edhe para trupit gjykues, jo vetëm aq sa është në ndërgjegjen time. Bazuar në përmbajtjen e këtyre vendimeve për shtetasin Ll. K., në cilësinë e të dyshuarit/të pandehurit, rezulton se në asnjë rast nuk kam marrë pjesë në gjykimin e asnjë prej çështjeve të tij. Është e qartë se nuk kam shkelur etikën profesionale në lidhje me konfliktin e interesit, nuk kam pasur nevojë të heq dorë nga çështjet e këtij rasti, pasi nuk jam shortuar ndonjëherë rastësisht dhe, si e tillë, është e dukshme se kjo pikë e ankimit nuk qëndron si pretendim i ngritur ndaj meje.*
57. Pasi analizoi të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, si dhe të dhënat e akteve të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, të cilat u administruan në cilësinë e provës³³, në raport me pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me verifikimin e të dhënave për shtetasin

³³ Në seancën gjyqësore të datës 07.06.2022, u administruan aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si vijojnë.

▪ Shkresa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me nr. {***} prot., datë 23.05.2022, me lëndë "Kthim përgjigje", drejtuar z. Ludovik Dodaj, e cila ka bashkëlidhur:

- vendimin nr. {***}, datë 04.12.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- vendimin nr. {***}, datë 02.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

▪ Kërkesë e z. Ludovik Dodaj, datë 25.05.2022, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës, me objekt "Kopje të vendimeve për shtetasin LL.K."

▪ Shkresa e Gjykatës së Apelit Durrës (gjithsej 10 fletë), me nr. {***} prot., datë 25.05.2022, me lëndë "Dërgim vendimesh", drejtuar z. Ludovik Dodaj, e cila ka bashkëlidhur:

- vendimin me nr. {***}, datë 16.11.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës;
- vendimin nr. {***}, datë 01.04.2008, të Gjykatës së Apelit Durrës;
- vendimin nr. {***}, datë 17.10.2007, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Ll. K., të cilat mund të afektonin vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi³⁴ kryerjen e veprimeve hetimore, që konsistuan në kërkimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës të dosjes gjyqësore të vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të po kësaj gjykate. Në përgjigje të kërkesave procedurale për paraqitjen e akteve, trupi gjykues, në seancën e datës 27.06.2022, administroi shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2022³⁵, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, së cilës i ishte bashkëlidhur kopje e dosjes gjyqësore, që i përket vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të kësaj gjykate.

58. Në konkluzionet përfundimtare, pas njohjes paraprakisht me dokumentacionin e rezultuar nga hetimi i kryer³⁶, Komisioneri Publik u shpreh se nga aktet e administruara referuar ankimit, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë përfaqësuar akuzën gjatë fazave hetimore, si dhe gjatë gjykimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Ll. K.; ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendoi se edhe nga hetimi i kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultoi se ai nuk ka marrë pjesë në asnjë nga proceset gjyqësore në ngarkim të shtetasit të sipërcituar, duke u provuar qartësisht se nuk ka shkelur etikën profesionale, në lidhje me konfliktin e interesit.
59. Trupi gjykues, në vlerësim të këtij shkakut ankimi, konkluzioneve përfundimtare të parashtruara nga Komisioneri Publik, parashtrimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes, akteve të rezultuara e administruara si pasojë e veprimeve hetimore gjyqësore, vëren se ajo që dukshëm evidentohet nga përmbajtja e akteve të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shtetasin Ll. K., e që vlerësohet me interes në kuadër të këtij procesi, është se nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përfaqësuar organin e prokurorisë gjatë gjykimit të çështjes penale lidhur me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2009, ndaj shtetasit Ll. K., në të gjitha shkallët e gjykimit, e për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka disponuar me vendimin e sipërcituar, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë disponuar me vendimet e referuara në paragrafin 45 të këtij vendimi.
- Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk evidentoi rrethana që do të cenonin konkluzionin e Komisionit për vlerësimin mbi etikën dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016 dhe as elemente që duhen konsideruar bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
60. Në përmbledhje të sa është konkluduar më sipër, në analizë të problematikave të konstatuara, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, duke bërë një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të rrethanave faktike dhe

³⁴ Me vendim të ndërmjetëm, me shumicë votash, në seancën e datës 07.06.2022.

³⁵ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 10.06.2022.

³⁶ Me shkresën nr. {***} regj., datë 13.06.2022, trupi gjykues i komunikoi subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik kopjen e dosjes gjyqësore, që i përket vendimit nr. {***}, datë 02.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

të zbatimit të ligjit material, trupi arriti në konkluzionin se vendimi nr. 255, datë 08.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ludovik Dodaj, duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.07.2022.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtarët Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo, jemi pjesë e shumicës së trupit gjykues që mori vendimin përfundimtar për zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 255, datë 08.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, lidhur me zgjidhjen e pretendimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të gabuar, në analizën financiare për vitet 2013 dhe 2014, ka pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se balancat negative të këtyre viteve i ka mbuluar nëpërmjet kursimeve *cash* të akumuluar në vitet e mëparshme, vlerësojmë se balanca negative, në kontekstin e mungesës së burimeve të ligjshme, ishte më e thellë sesa ajo e konstatuar nga shumica; pasi shpjegimet e dhëna për herë të parë nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, bien ndesh me deklaratat periodike vjetore të tij. Në vlerësimin tonë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për një dinamikë të ndryshme të raportit mes kursimeve dhe shpenzimeve nga ajo e përcaktuar qartë nga ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, përbëjnë një përpjekje retroaktive për të pasqyruar një situatë të pavërtetë, në një mënyrë që e favorizon subjektin.
2. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se përlllogaritja e balancës negative duhet të kishte ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi me atë që parashtrroi Komisioneri Publik, duke marrë për bazë deklaratimet e përvitshme të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 9049/2003, për shtesa të gjendjes së *cash*-it në banesë nga kursimet vjetore. Kjo qasje do të ishte në përputhje me atë të ndjekur nga Kolegji në çështje të mëparshme³⁷. Sipas shumicës së trupit gjykues, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* për pakësime të *cash*-it, të padeklaruara më parë në deklaratat periodike të viteve 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh në vlerën prej 1.704.795 lekësh.
3. Ne gjyqtarët e këtij mendimi paralel, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se në përlllogaritjet e kryera për analizën financiare të viteve 2013 dhe 2014, nuk duhet të pranohet pretendimi i subjektit për përdorimin e kursimeve të mëparshme gjendje *cash* për efekt të krijimit të pasurive dhe përbalimit të shpenzimeve në shumat respektive prej 560.416 lekësh në vitin 2013 dhe 600.000 lekësh në vitin 2014. Në gjykimin tonë, balancës negative të përcaktuar nga shumica e trupit gjykues për këto vite, përkatësisht në vlerat e 122.538 lekëve për vitin 2013 dhe 51.722 lekëve për vitin 2014, duhet t'i shtohen respektivisht shumat e identifikuar më sipër. Nga ky arsyetim, mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, arrin vlerën e 2.865.211 lekëve, e cila është e përafërt me atë të pretenduar nga Komisioneri Publik.
4. Në vlerësimin tonë, nën dritën e peshës që i ka dhënë ligji vlerës provuese të deklaratave periodike vjetore, të lexuara në harmoni me deklaratën e pasurisë *vetting*, mënyra e pasqyrimit të fakteve në këtë të fundit, që përmbys sa është deklaruar në vitet që paraqesin problematika për subjektin e rivlerësimit në raportin mes të ardhurave dhe shpenzimeve, është jobindëse. Në deklaratat periodike në fjalë, në zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, nën përgjegjësi, subjekti ka

³⁷ Ndër të tjera, te çështja që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka [JR nr. 27/2020], E. Islami [JR nr. 11/2019], Xh. Zaganjori [JR nr. 19/2019], E. Sadiku [JR 07/2019].

deklaruar vlerën e likuiditeteve, shtesat e gjendjes *cash*, në lekë ose në valutë të huaj, më 31 dhjetor të vitit të deklarimit në raport me vitin pararendës. Kjo dispozitë dhe formulari në zbatim të saj, duke përcaktuar qartë detyrimin për të deklaruar *gjendjen e likuiditeteve*, e bën të pabesueshëm pretendimin për “një pasaktësi për pakësimin e *cash-it*”, nga një magjistrat me përvojë të gjatë dhe me detyra me përgjegjësi të lartë në karrierën e tij në prokurori. Përzierja e shtesave dhe pakësimeve në nivel konceptual prej tij, siç pretendon subjekti të ketë ndodhur dhe korrigjuar vetëm në vite të caktuara, e bën të pamundur kontrollin e pasurive të tij në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe e bën të pakuptimtë parashikimin ligjor të germës “d” të nenit 4 të ligjit të sipërcituar.

5. Për pasojë, pretendimet për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting* të subjektit të rivlerësimit për krijim pasurie me burim nga kursimet *cash* të viteve të mëparshme, dinamikë e cila nuk ishte shpjeguar në kohën kur janë akumuluar kursimet dhe kryer shpenzimet, apo në vitet pasuese, në vlerësimin tonë, janë kryer për të anashkaluar mungesat e burimeve të ligjshme të konstatuara nga subjekti në momentin e plotësimit të kësaj deklarate. Për rrjedhojë, deklarinet e tij në deklaratën e pasurisë *vetting* për përdorim kursimesh të paspecifikuara më parë, përbëjnë një përpjekje për ta paraqitur situatën në një dritë të favorshme, që nuk pasqyron realitetin. Për sa më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit rezulton me pasuri të pajustificuar në një vlerë më të lartë sesa ajo e pranuar në konkluzionin përfundimtar nga shumica e trupit gjykues lidhur me trajtimin e kësaj problematike.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 28, datë 14.07.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Subjekti i rivlerësimit Ludovik Dodaj iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*, për të tria kriteret e rivlerësimit për të cilat Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë, me arsyetimin se:

[...] subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parim

Subjekti rezulton me një bilanc negativ në vitin 2008 në shumën 358.816 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në vitin 2008 nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...] subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës "a" të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Komisioneri Publik ka kërkuar në ankim, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin e vendimit të Komisionit lidhur me pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarimin e subjektit për pasurinë apartament banimi.
5. Shumica e trupit gjykues në Kolegji, në përfundim të gjykimit, ka konkluduar në paragrafin 48 të vendimit se:

[...] mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me kryerjen e pagesave të kësteve për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 108,48 m², në Durrës e kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2008 dhe 2009, si dhe për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitet 2013 dhe

2014, rezultoi në shumën totale 1.704.795 lekë. Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme rezultoi në një nivel të pajustificueshëm, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter vlerësimi, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

6. Në vlerësimin tim, vendimi i marrë nga shumica e trupit gjykues, lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, në vlerën 1.704.795 lekë, në një interpretim më të gjerë, të drejtë ligjor dhe tërësor të çështjes, kjo balancë negative nuk do të ishte domethënëse për t'u aplikuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Ludovik Doda.
7. Nga shqyrtimi i çështjes, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit prej vitit 1983, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në momentin e gjykimit të çështjes në Kolegj.
8. Referuar ankimit, vërehet se Komisioneri është përqendruar në pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklaram nga ana e subjektit për krijimin e pasurisë. Çmoj të drejtë këtë konstatim lidhur me pasaktësinë në deklaram për kursimet e subjektit në deklaratat periodike, por subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaram kursime ndër vite para vitit 2006, si burim krijimi, ndër të tjera, për apartamentin objekt shqyrtimi që, referuar analizës financiare, kishte mundësi kursimi, por nuk i ka deklaram kursimet në deklaratat periodike të viteve 2004-2005, deri më datë 21.08.2006, moment i likuidimit të kështit të parë të apartamentit.
9. Gjithashtu, në shqyrtimin e kësaj çështjeje, *lidhur me huan në vlerën 8.000 euro, financuar nga kunati, z. A. D., në shumën 8.000 euro, e cila ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë, si dhe shlyerjen e kështit të apartamentit, në vitin 2009, në vlerësimin tim, nga shumica e trupit gjykues nuk janë marrë në konsideratë disa rrethana specifike sa i përket kësaj marrëdhënieje huaje, konkretisht nuk janë vlerësuar drejt pretendimet e subjektit të rivlerësimit në seancë publike, se personi tjetër i lidhur, z. A. D., së bashku me bashkëshorten kanë punuar në bujqësi në shtetin grek që prej vitit 1998, dhe kanë banuar në shtëpinë e familjes që i kishte punësuar, me ushqim dhe fjetje të siguruar. Në rastin konkret, personi tjetër i lidhur, për periudhën 2005-2009, ka krijuar të ardhura të tatueshme në shumën 54.413 euro, të cilat, sipas Komisionit, janë të mjaftueshme për dhënien e huas 8.000 euro (6000 euro + 2000 euro) përgjatë vitit 2009, ndërsa sipas analizës financiare në Kolegj, për periudhën 2003 - janar 2009, totali i të ardhurave ka qenë 58.412 euro që janë të ardhurat e ligjshme sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të pamjaftueshme këto për të mbuluar shpenzimet jetike në vlerën 73.426 euro. Kundërshtoj këtë arsyetim të shumicës në vendim, pasi në një analizë të thjeshtë, personi tjetër i lidhur nuk mund të ketë konsumuar rreth 26% më tepër se të ardhurat e realizuara, minimalisht mund të kishte konsumuar në masën e përfituar. Për më tepër, vlera e shpenzimeve jetike e përllogaritur sipas *eurostat*-it, shtrihet mbi baza të dhënash në rang vendi, ndërkohë që personi tjetër i lidhur ka jetuar në {***}, Greqi, periferi me shpenzime më të ulëta. Shumica e trupit gjykues nuk mund të anashkalojë këtë fakt, me efekt konkret në përllogaritjen e mundësisë për kursim të personit tjetër të lidhur, duke rënduar zërin shpenzime, me shpenzime qiraje dhe ushqimi me peshën më të lartë në këtë zë. Ndryshe nga shumica, kam bindje se kjo hua duhet të ishte marrë me rezervë në vlerësimin tërësor të rrethanave, fakteve, deklaramin e saj në deklaratën periodike të vitit 2009 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti ka qenë korrekt në deklaramin e kësaj huaje në deklaratat përkatëse.*

10. Nga vlerësimi në tërësi i kësaj çështjeje, konstatoj se pasuria totale e krijuar nga subjekti i rivlerësimit Ludovik Dodaj, përgjatë 39 viteve punë, konsiston në një apartament banimi të blerë me kredi, ndodhur në qytetin e Durrësit, me vlerë 45.000 euro, dhe një automjet me vlerë 9.500 euro. Parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, parashikuar në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes, me synimin që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Edhe në qoftë se i referohemi dispozitës, përkatësisht nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, *nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*, në asnjë rast subjekti nuk ndodhet në kushtet e fshehjes, deklaratimit të rremë, ose të paraqitjes në mënyrë të pasaktë të pasurive në pronësi apo përdorim sipas kësaj dispozite, pasi deklaratimet periodike kishin përputhje me atë çfarë është deklaruar në deklaratën e pasurisë, *vetting*, lidhur me apartamentin objekt gjykimi, për sa i përket burimit të krijimit, mënyrës së likuidimit në këste, çmimit të apartamentit, por pasaktësia për mua si gjyqtare në pakicë, ishte mosdeklarimi i kursimeve të tij në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar.
11. Duke marrë parasysh rrethanat më sipër, vlerën e apartamentit, mënyrën e likuidimit në pesë këste, për një periudhë 2006-2012, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e pasurisë, nuk duhet të kualifikohet sipas neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Prandaj, votova kundër shumicës për sa i përket mënyrës së arsytimit dhe zgjidhjes përfundimtare të çështjes nga shumica e trupit gjykues. Në vlerësimin tim, vendimi nr. 255, datë 08.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të ishte lënë në fuqi.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, kundër vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet të cilit është vendosur ndryshimi i vendimit të mësipërm të Komisionit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj. Kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Komisionit, i cili kishte vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit rivlerësimit, duke u mbështetur në arsytet si më poshtë.
2. Vota kundër vendimit të shumicës ka ardhur si pasojë e një vlerësimi të ndryshëm të vlerës që tregon mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e apartamentit me sipërfaqe 108,48 m², me vlerë 45.000 euro, në pronësi të subjektit, lidhur me: **(i)** komponentët e kësaj shume; dhe **(ii)** peshën që një balancë negative e mbështetur, sipas arsytimit tim, në rrethana fakti e argumente të diskutueshme e jo fort të sigurt, duhet të ketë në drejtim të krijimit të nivelit të besueshmërisë për burimet e ligjshme të pasurisë së subjektit.
3. **Së pari**, ndonëse formalisht dhe në një vlerësim matematikor, vlera e konsideruar se përfaqëson balancën negative të subjektit të rivlerësimit për financimin e apartamentit në pronësi të tij dhe shpenzimeve në vitet 2013-2014, duket se kap vlerën e pranuar nga trupi gjykues prej 1.704.795 lekësh, mbështetur në argumentet e mëposhtme, konstatoj se ekzistojnë disa të rrethana që cenojnë bindjen se kjo vlerë i përgjigjet doemos realitetit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit në momentin e krijimit të pasurisë objekt analize dhe situatës financiare të marrë në shqyrtim prej Kolegjit.

3.1 Komponentë të kësaj shume konstatohet të jenë: **(i)** balanca negative e cila rezulton nga analiza financiare e vitit 2006, për pagimin e këstit prej 25.000 eurosh për financimin e apartamentit, në vlerën prej 163.959 lekësh; **(ii)** balanca negative e cila rezulton prej analizës financiare të vitit 2008, në vlerën prej 358.816 lekësh; **(iii)** balanca negative në vlerën 1.007.760 lekë në vitin 2009, që vjen si pasojë e shlyerjes së kredisë dhe pagimit të këstit të fundit të çmimit të apartamentit dhe mosnjohjen si të ardhur të ligjshme të shumës prej 8000 eurosh, të marrë hua prej personit tjetër të lidhur; **(iv)** balanca negative e analizës financiare të viteve 2013 e 2014, respektivisht në vlerat 122.538 lekë dhe 51.722 lekë.

Shumatorja e këtyre balancave negative ka rezultuar të jetë në vlerën prej 1.704.795 lekësh, vlerë e cila ka shërbyer, sipas vlerësimit të trupit gjykues, si një mungesë e cila nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit, me pasojë mosvendosjen e masës disiplinore, dhe është konsideruar se e ka vendosur subjektin në kushtet e një deklarimi të pasaktë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3.2 Brenda shumës së konsideruar se përbën balancën negative si pasojë e kontrollit e verifikimit të burimeve të ligjshme të subjektit, pesha më e madhe e kësaj balance, në vlerën prej 1.007.760 lekësh, rezulton të jetë krijuar nga dështimi i subjektit për të provuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 8000 eurosh, të dhënë hua atij, prej personit tjetër të lidhur, vëllait të bashkëshortes, z. A. D., në vitin 2009. Kjo shumë ka shërbyer, sipas deklarimeve të subjektit, si burim për shlyerjen e parakohshme, në datën 03.02.2009, të një pjese të kredisë që subjekti kishte marrë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), si dhe të një pjese të këstit prej 4000 eurosh, të paguar për shlyerjen e vlerës së apartamentit në datën 16.09.2009.

3.3 Lidhur me këtë hua, shumica ka arritur në konkluzionin se ndonëse krijohet bindja për vërtetësinë e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, mbështetur në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike, në atë *vetting*, si dhe në faktet që kanë rezultuar prej hetimit administrativ, subjekti nuk ka arritur të provojë se personi tjetër i lidhur kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën prej 8000 eurosh në vitin 2009.

3.4 Ky qëndrim i shumicës vjen në harmoni edhe me qëndrimet e tjera të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, për të cilët është pranuar se duhet të provohet se kanë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë në transaksion, nëpërmjet një analize të arsyeshme e logjike, konsideruar disa rrethana objektive që lidhen me jetën e tyre dhe arsyetimin mbi mundësinë e krijimit të pasurive të dhëna hua apo dhuratë subjekteve të rivlerësimit.

3.5 Në këndvështrim të këtij argumenti, nga hetimi administrativ edhe gjyqësor, kanë rezultuar së paku dy të dhëna të pranuar edhe nga shumica: *së pari*, është konstatuar se personi tjetër i lidhur, vëllai i bashkëshortes së subjektit, ka qenë emigrant në shtetin grek që në vitin 1998, siç rezulton nga formulari i kërkesës për t'u pajisur me leje qëndrimi, lëshuar nga Ministria e Punës Greke; *së dyti*, rezulton që të ardhurat e ligjshme të fituara prej tij, të cilat kanë rezultuar nga të dhënat e formularëve përkatës, pas zbritjes së tatimit të paguar nga personi i tjetër i lidhur dhe bashkëshortja e tij, nga viti 2003 deri më 31.01.2009, janë në vlerën prej 58.412 eurosh, ndërsa për periudhën shkurt - gusht 2009, në vlerën prej 6.636 eurosh.

3.6 Këto konkluzione janë analizuar në raport me shifrën e llogaritur për shpenzime jetese të familjes së personit tjetër të lidhur në këto vite, në vlerën e cila, sipas të dhënave të gjendura në faqen zyrtare të statistikave *eurostat* për shtetasit grekë në nivelin e varfërisë, rezulton të jetë 73.466 euro, dhe është arritur në përfundimin se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme shumën prej 8000 eurosh.

3.7 Kam vlerësuar se ky konkluzion i arritur prej shumicës, duhet të konsiderohet me rezervë në zbatim të parimit të objektivitetit, pasi: *Së pari*, analiza i referohet një individit që nuk ka deklarime dhe as të dhëna në shtetin shqiptar për të kuptuar realisht situatën financiare të tij. *Së dyti*, pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna, fakti i pranuar edhe nga shumica se personi tjetër i lidhur ka jetuar si emigrant në shtetin grek që prej vitit 1998, krijon prezumimin logjik se ai ka shpenzuar për të jetuar dhe se ka pasur të ardhura, pavarësisht se nuk ka deklarime për këto shuma në organet fiskale të shtetit grek apo se subjekti nuk ka arritur t'i provojë ato në proces. *Së treti*, vërtet që është përdorur si standard për matjen e shpenzimeve jetike të personit tjetër të lidhur, standardi i nivelit të varfërisë për një shtetas grek, por jo domosdoshmërisht ky është i njëjti me standardin e përdorur për të jetuar nga një shtetas shqiptar, emigrant, i cili kulturalisht dhe objektivisht, për shkak të historisë së vendit të tij, nuk mund të prezumohet se ka të njëjtin nivel jetese apo të njëjtat shpenzime për zëra të ndryshëm të paketës që mat shpenzimet jetike, si një shtetas grek. Qoftë nevojat, pritshmëritë apo edhe aspiratat dhe stili i jetesës së një emigranti nuk janë natyrshëm si ato të një vendasi, të paktën në vitet e para të jetesës në një vend të huaj. *Së katërti*, në logjikën matematikore të përdorur, personi tjetër i lidhur nuk rezulton të ketë pasur mundësi as të jetojë, duke qenë se, sipas standardit të *eurostat*-it të përdorur për përcaktimin e shpenzimeve të tij, ai ka fituar më pak se ka detyrimisht shpenzuar për jetesë, alogjizëm ky që nuk i jep përgjigje pyetjes nëse ai ka pasur të ardhura të tjera, të cilat nuk janë deklaruar ose për të cilat mungon dokumentacioni provues. *Së pesti*, rezulton se personi tjetër i lidhur dhe bashkëshortja e tij të paktën që prej vitit 2003, janë të punësuar në mënyrë të rregullt dhe deklarojnë të ardhurat e tyre

para organeve fiskale të shtetit grek, fakt që tregon për një lloj stabiliteti financiar të tyre, të paktën që prej kësaj kohe.

3.8 Duke pasur në konsideratë argumentet e renditura më lart, kam vlerësuar se konkluzioni që personi tjetër i lidhur nuk ka pasur të japë hua një shumë prej 8000 eurosh, ndërsa provohet se ka jetuar në shtetin grek që prej vitit 1998 dhe ka përfituar të ardhura të ligjshme të paktën që prej vitit 2003 në një vlerë prej 65.048 eurosh, nuk duhet konsideruar plotësisht i vërtetë dhe krijon premisa për pasjen e një efekti të moderuar në vlerësimin e situatës financiare të subjektit. Kjo do të thotë që balanca negative prej 1.004.795 lekësh në vitin 2009, duhet të vlerësohet objektivisht në analizë, duke përcaktuar peshën që ajo do të ketë në vlerësimin e pasurisë, në këndvështrim të metodologjisë së përdorur për kalkulimin e saj dhe rrethanave konkrete të rastit.

4. Një tjetër balancë negative e cila, sipas mendimit tim, meritonte një vlerësim të ndryshëm, është shuma prej 122.538 lekësh, e cila ka rezultuar që përfaqëson mungesën e burimeve të ligjshme nga analiza financiare e vitit 2013. Ndonëse kjo shumë rezulton si një produkt matematikor i të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin tim, do të duhej të merrej me rezervë pas një analize logjike të vitit financiar. Diferenca negative në këtë vit, ka rezultuar edhe si produkt i konsiderimit si shpenzim, ndër të tjera, të vlerës prej 280.420 lekësh, paguar si këst i fundit i shlyerjes së huas së subjektit ndaj kumatit të tij, personit tjetër të lidhur, z. A. D.. Vendosja e kësaj shume si shpenzim në analizë, ka ardhur si pasojë e deklarimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore se ka shlyer plotësisht huan e kumatit në këtë vit deklarues, në shumën prej 2000 eurosh. Ndonëse në terma literalë, duket se kjo shumë përfaqëson një shpenzim të këtij viti, në terma logjikë, duket e pavend të ngarkohet subjekti me shpenzime për shlyerjen e një huaje, e cila për shkaqet e përshkruara më lart, nuk është bërë pjesë e të ardhurave të tij në vitin përkatës, madje është konsideruar se ka prodhuar një mungesë burimesh në atë vit. Në kushtet e trajtimit të këtij shpenzimi logjikisht si të pangarkueshëm në analizën financiare të subjektit, rezultati financiar i këtij viti do të ishte pozitiv dhe shumatorja e bilancit negativ do të ulej me vlerën 122.538 lekë.
5. **Së dyti**, duke u mbështetur tek arsyetimi i mësipërm, kam vlerësuar diferencën negative të konkluduar nga shumica, në zbatim të parimit të proporcionalitetit sipas përcaktimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të pasur një vlerësim të drejtë të peshës dhe ndikimit që duhet të ketë kjo balancë në arritjen e një përfundimi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit e më pas, në kuptim të vlerësimit të tri kriterëve të gjithë procesit të tij të rivlerësimit.

5.1 Në këtë drejtim të analizës, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka punuar si prokuror që prej vitit 1988 dhe se pasuria në pronësi e tij, e cila ka qenë objekt kontrolli e verifikimi sipas deklaratimit në deklaratën *vetting*, për të cilën është konkluduar se nuk justifikohen burimet e financimit në vlerën prej 1.530.535 lekësh, është e vetmja pasuri e paluajtshme e prokurorit dhe përfaqëson banesën në të cilën ka jetuar ai dhe familja e tij. Nga aktet, rezulton se kjo pasuri, apartament me sipërfaqe 108,48 m², ndodhet në zonën e plazhit në qytetin e Durrësit, është blerë në vitin 2006 pasi subjekti kishte shitur banesën në pronësi të tij në qytetin e Shkodrës, ku ai jetonte. Konstatohet në këto kushte se blerja e kësaj pasurie ka qenë një nevojë për strehimin dhe jetesën e familjes së subjektit, për më tepër në një qytet ku ai ushtronte detyrën e prokurorit e që nuk ishte qyteti i tij i lindjes. Në këtë kuptim, nevoja për t'u ndihmuar edhe nga familjarët e afërt për të arritur financimin e kësaj pasurie të domosdoshme për një jetesë normale, duket e besueshme dhe arsyeshme.

5.2 Në këto kushte, mungesa e burimeve të ligjshme, e shkaktuar në masën më të madhe për shkak të mosprovueshmërisë së burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur për të justifikuar huan, nuk rezulton të jetë një shkelje apo problematikë që është shkaktuar drejtpërdrejt nga sjella e subjektit. Duket e arsyeshme që një kryefamiljar, për të siguruar nevojat për strehim të familjes së tij, të neglizhojë kujdesin maksimal për verifikimin e burimeve të atij që i mundëson nëpërmjet huadhënies, financimin e banesës familjare. Për më tepër që ky individ është gjithashtu një familjar, e me qëndresë afatgjatë në një shtet të huaj dhe shuma e marrë hua duket brenda logjikës dhe arsyes së një mbështetjeje financiare të përkohshme brenda rrethit familjar.

5.3 Përveç sa më sipër, duke marrë në konsideratë edhe deklaratimet e tij në deklaratat e pasurisë, por edhe rezultatet e hetimit, vërehet se subjekti, së bashku me familjen, ka bërë një jetë modeste, me shpenzime që duket se janë në përputhje me situatën financiare të tij dhe edhe me vetë natyrën e profilit e funksionit që ai ka ushtruar. E njëjta situatë vihet re edhe pas punësimit të fëmijëve të tij e të ardhurave e shpenzimeve të jetesës së deklaruar prej tyre.

6. Për të gjitha sa kam arsyetuar më lart, balanca negative e konkluduar prej shumicës, e që përmban brenda saj vlera së paku të diskutueshme, nuk është e mjaftueshëm për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit, në kuptim të përcaktimit të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
7. Sipas mendimit tim, problematikat e konstatuara lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të konsiderohen si të kapërcyeshme dhe të paaftha për ta vendosur subjektin nën regjimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë nuk mund të shkaktojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit.
8. Për sa më lart, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 255, datë 08.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi